

RAPORTI NJËVJEÇAR I MONITORIMIT  
Një vit monitorim për më shumë transparencë  
Shtator 2013, Prizren

## PËRMBAJTJE

I. Përmbledhje Ekzekutive .....	2
II. Monitorimi në Komunën e Prizrenit .....	3
III. Monitorimi në Komunën e Mamushës .....	6
IV. Konstatime të përgjithshme mbi transparencën .....	6
V. Të gjeturat specifike të monitorimit .....	7
VI. Rekomandime .....	10
VII. Aktivitetet/raportimi .....	12
VIII. Ndikimi i projektit .....	13
IX. Për projektin .....	14
X. Pse monitorimi i transparencës .....	15
XI. Falënderim .....	16
EC Ma Ndryshe .....	17

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës”, i përkrahur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*



British Embassy  
Pristina

## I. Përmbledhje ekzekutive

Raporti i titulluar “Një vit monitorim për më shumë transparencë” përfshin punën njëvjeçare të OJQ-së “EC Ma Ndryshe” në monitorimin e transparencës së komunës së Prizrenit dhe punën disa mujore në monitorimin e transparencës së komunës së Mamushës. Kjo analizë është përgatitur në kuadër të projektit “Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës” dhe përfshin të gjeturat që lidhen me dikastere të ndryshme të këtyre qeverive lokale, me një theks të veçantë në transparencë dhe përpjekjet për përmirësimin e kësaj fushe të rëndësishme të qeverisjes lokale si parakusht për një demokraci të qëndrueshme.

Në shtator të vitit 2012, “EC Ma Ndryshe”, Komuna e Prizrenit dhe Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për fillimin e zbatimit të projektit “Transparenca Online e Komunës së Prizrenit”<sup>1</sup>. Ndërsa të arriturat e projektit "Transparency Online" në Prizren kanë qenë një faktor motivues për të zgjeruar monitorimin edhe në një komunë shtesë, respektivisht atë të Mamushës nga maji i 2013-s<sup>2</sup>.

“EC Ma Ndryshe” bazuar në dispozitat ligjore që përkufizojnë të drejtën në qasje në dokumente publike dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje ka kryer rolin e monitoruesit, duke përcjellë, hulumtuar dhe raportuar për vendimet dhe dukuritë që nuk janë në përputhje me ligjin apo obligimet morale të qeverisjes së mirë. Gjatë një viti monitoruesit e

EC Ma Ndryshe kanë identifikuar shkelje të shumta në raport me qeverisjen lokale, të cilat i ka adresuar në publik përmes komunikatave, konferencave për shtyp, debateve, ndërkohë që ka kërkuar edhe intervenim nga niveli qendror, në rastet kur kompetencat ligjore e kanë paraparë një gjë të tillë.

Brenda periudhës 12 mujore monitorimi ka njoftuar opinionin në lidhje me defektet në urbanizëm, inspektorat, në arsim, shëndetësi, prokurim, shërbime publike, transparencë, financa dhe buxhet, investimet jo të qëlluara, por edhe komunikimin me nivelin qendror dhe zbatimin e vendimeve ligjore të autoriteteve më të larta shtetërore. Me kalimin e kohës, puna e monitoruesve është vlerësuar nga qytetarët, të cilët kanë nisur që të raportojnë shqetësimet, parregullsitë apo shkeljet ligjore në nivel komunal.

Ajo që vlen të theksohet është se përkundër një numri të madh të komunikatave dhe debateve rreth këtyre çështjeve, ku janë përpiluar rekomandime konkrete, qeveria lokale ka treguar pak vullnet për zbatimin e këtyre rekomandimeve rrjedhimisht dhe përmirësimin e defekteve të argumentuara nga shoqëria civile.

Megjithëkëtë monitorimi ka prodhuar edhe rezultate pozitive, si lejimi i monitoruesve për të marrë pjesë në mbledhjet e qeverisë komunale dhe për të raportuar për vendimet e marra. Gjithashtu autoritetet komunale kanë rritur nivelin e përgjegjësisë sa i përket ofrimit të qasjes në dokumentet publike dhe vendimet e lidershipit komunal.

Një tjetër çështje inkurajuese për monitoruesit ka qenë reagimi i nivelit qendror në lidhje me të gjeturat e monitorimit. Niveli qendror i qeverisjes ka treguar një shkallë më të lartë të

<sup>1</sup> Teksti i plotë i Memorandumit mund të gjendet në linkun: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Memorandumi\\_UK-EC-PZ.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Memorandumi_UK-EC-PZ.pdf)

<sup>2</sup> Njoftimi për Mamushë, linku: <http://www.online-transparency.org/?page=1,42,40>

përgjegjësisë, duke i marrë për bazë komunikatat e lëshuara në kuadër të projektit dhe ka ofruar përgjigje për monitoruesit, sikurse që ka adresuar rekomandime tek lideri komunal për përmirësimin e shkeljeve apo marrjen e masave të duhur për vendosjen e ligjshmërisë në rastet e caktuara, si MAPL në rastin “Dardania”, pastaj MMPH në rastin “Prevalla”, MAPL-ja dhe MMPH-ja në çështjen e rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Monitoruesit gjatë angazhimit të tyre njëvjeçar megjithëse kanë qenë të përqendruar në çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale kanë adresuar edhe tema të interesit nacional, siç është rasti i projektit Brezovica, që rrezikon vlerat e rralla natyrore.

Për dallim prej Prizrenit, në rastin e komunës së Mamushës përgjigja ndaj monitorimit dhe të gjeturave të monitoruesve ka qenë më pozitive. Udhëheqja e kësaj komune asnjëherë nuk ka kontestuar të gjeturat e monitoruesve dhe në disa raste ka dhënë premtime se do të angazhohet për përmirësimin e defekteve të identifikuara. Madje ka mirëpritur edhe propozimet për fuqizimin e kapaciteteve në sferën e transparencës në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Rekomandimet e përgjithshme (transparenca):

- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 2008/09 i MAPL-së,
- Ekzekutivi lokal të raportoj më shpesh në media për çështjet publike,
- Kryetari, drejtorët dhe shefi i Zyrës për Informim të mbajnë konferenca periodike të shtypit
- Të amendamentohet Rregullorja për Transparencë,

- Zyra për Informim të fuqizohet me personel dhe të bëjë përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës,
- Të zbatohen në përpikëri dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike,
- Ueb faqet zyrtare të përditësohen me përmbajtje në të gjitha gjuhët zyrtare

Rekomandimet specifike (sektoriale)

#### a) Prizren

- Të zbatohet Ligji i Prokurimit Publik,
- Të zbatohen të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm,
- Të ndalohet vendosja e Lojërave në Qendrën Sportive,
- Të ndërpritet praktika e grumbullimit të hollave nga nxënësit,
- Të rishqyrtohet projekti “Brezovica”,
- Paratë publike mos të investohen në projektet me konteste pronësore,
- Të ndalohen tejkallimet në ndërtimet e larta,
- Të hartohet lista e objekteve për rrënim.

#### b) Mamushë

- Të zbatohen rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm,
- Të kontrollohen shpenzimet në pjesën e dytë të vitit,
- Të përmirësohet transparenca online e komunës,
- Të zgjidhjet çështja e emërimit të shkollës në Mamushë

## II. Monitorimi në Komunën e Prizrenit

Në shtator të vitit 2012, “EC Ma Ndryshe”, Komuna e Prizrenit dhe Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për fillimin e zbatimit të projektit “Transparenca Online e Komunës së Prizrenit”. Në këtë memorandum janë përshkruar

përgjegjësitë e secilit akterë në përpjekjet për rritjen e transparencës komunale. Në këtë mënyrë është formalizuar bashkëpunimi i palëve, i cili megjithatë nuk ka arritur që të tejkaloj dallimet në pikëpamje mes komunës së Prizrenit dhe “EC Ma Ndryshes”-s, sa i përket kuptimit të obligimeve ligjore ndaj transparencës dhe zbatimit të këtyre obligimeve në praktikë.

Përkundër këtyre dallimeve, “EC Ma Ndryshe” bazuar në dispozitat ligjore që përkufizojnë të drejtën në qasje në dokumente publike dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje ka kryer rolin e monitoruesit, duke përcjellë, hulumtuar dhe raportuar për vendimet dhe dukuritë që nuk janë në përputhje me ligjin apo obligimet morale të qeverisjes së mirë. Gjatë një viti monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë identifikuar shkelje të shumta në raport me qeverisjen lokale, të cilat i ka adresuar në publik përmes komunikatave, konferencave për shtyp, debateve, ndërkohë që ka kërkuar edhe intervenim nga niveli qendror, në rastet kur kompetencat ligjore e kanë paraparë një gjë të tillë.

Brenda periudhës 12 mujore EC Ma Ndryshe ka njoftuar opinionin në lidhje me defektet në urbanizëm, inspektorat, në arsim, shëndetësi, prokurim, shërbime publike, transparencë, financa dhe buxhet, investimet jo të qëlluara, por edhe komunikimin me nivelin qendror dhe zbatimin e vendimeve ligjore të autoriteteve më të larta shtetërore.

Me kalimin e kohës, puna e monitoruesve është vlerësuar nga qytetarët, të cilët kanë nisur që të raportojnë shqetësimet, parregullsitë apo shkeljet ligjore në raport me Komunën e Prizrenit. Në sajë të komunikimit me qytetarët janë raportuar defektet në lidhje me ndriçimin publik, vendosjen e Lojërave në hapësira

publike dhe praktikën e grumbullimit të hollave nga nxënësit në shkollat publike.

Ajo që vlen të theksohet është se përkundër një numri të madh të komunikatave dhe debateve rreth këtyre çështjeve, ku janë përpiluar rekomandime konkrete, qeveria lokale ka treguar pak vullnet për zbatimin e këtyre rekomandimeve rrjedhimisht dhe përmirësimin e defekteve të argumentuara nga shoqëria civile. Në vend se të ketë reflektim në lidhje me këto çështje, udhëheqja komunale ka zgjedhur një rrugë tjetër, atë të përdorimit të gjuhës disiplinuese dhe të qasjes paternaliste ndaj monitoruesve. Në këtë mënyrë të gjeturat e monitoruesve të EC Ma Ndryshe që kanë qenë të argumentuara bazuar në të dhënat e siguruara nga dikasteret e qeverisë komunale apo të autoriteteve shtetërore janë trajtuar si kritika me prapavijë politike dhe jo si adresim i të metave të qeverisjes lokale që do të mund të përmirësoheshin me veprime konkrete dhe me një dialog më të strukturuar me monitoruesit e EC Ma Ndryshe, në veçanti dhe organizatat e shoqërisë civile, në përgjithësi.

Megjithëkëtë monitorimi ka prodhuar edhe rezultate pozitive, si lejimi i monitoruesve për të marrë pjesë në mbledhjet e qeverisë komunale dhe për të raportuar për vendimet e marra. Gjithashtu autoritetet komunale kanë rritur nivelin e përgjegjësisë sa i përket ofrimit të qasjes në dokumentet publike dhe vendimet e lidershipit komunal.

Një tjetër çështje inkurajuese për monitoruesit e EC Ma Ndryshe ka qenë reagimi i nivelit qendror në lidhje me të gjeturat e monitorimit. Niveli qendror i qeverisjes ka treguar një shkallë më të lartë të përgjegjësisë, duke i marrë për bazë komunikatat e lëshuara në kuadër të projektit dhe ka ofruar përgjigje për monitoruesit, sikurse që ka adresuar

rekomandime tek lidhshipi komunal për përmirësimin e shkëlqeve apo marrjen e masave të duhura për vendosjen e ligjshmërisë në rastet e caktuara.

Kështu, në nëntor të 2012-ës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka dërguar një shkresë ligjore Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për rastin e ndërtesave kolektive në lagjen "Dardania". Pas reagimit të EC Ma Ndryshe në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkesës drejtuar MAPL-së për të ndërmarrë veprime ndaj zyrtarëve të komunës së Prizrenit, Ministri i MAPL-së, Slobodan Petrovic në letrën e tij dërguar kryetarit Ramadan Muja dhe kryesuesit të KK-së, Nijazi Kryeziu, ndër të tjerash kërkon të informohet "për hapat e ndërmarrë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese"<sup>3</sup>.

Një tjetër zhvillim inkurajues ka ndodhur në maj të këtij viti kur Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pat marrë vendim që të ndërpriten të gjitha aktivitetet ndërtimore në zonën e Prevallës deri në afat të pacaktuar<sup>4</sup>. Këtë vendim, ministri i MMPH-së, Dardan Gashi e ka marrë pas degradimit të mjedisit, gjegjësisht tejkalimit të kushteve dhe kriterëve për ndërtim dhe mosrespektimin e udhëzuesit të MMPH-së që ju ka dërguar Komunës së Prizrenit për mënyrën e zbatimit të planit urban për këtë zonë, gjë që është konstatuar disa herë më parë në komunikatat dhe analizat e "EC Ma Ndryshe".

<sup>3</sup> Shkresa e Ministrit të MAPL-së në linkun: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Shkrese\\_MAPL.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Shkrese_MAPL.pdf)

<sup>4</sup> Njoftimi në linkun: <http://mmp-h.org/sq/Lajmet/Nderpriten-te-gjitha-ndertimet-ne-Prevalle-650>

Ndërkaq në lëvizje janë vënë edhe mekanizmat e drejtësisë, me ç'rast Prokuroria Themelore e Prizrenit ka iniciuar hetimet në lidhje me shkeljet e kriterëve urbanistike në Prizren por edhe në Prevallë<sup>5</sup>.

Gjatë periudhës njëvjeçare "EC Ma Ndryshe" ka bashkëpunuar edhe me organizatat tjera monitoruese që veprojnë në Prizren. EC Ma Ndryshe dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) nga afër kanë përcjellë procesin e hartimit dhe të miratimit të rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje nga Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe konstatimi i përbashkët i këtyre dy organizatave që monitorojnë legjislativin dhe ekzekutivin e komunës së Prizrenit ka qenë se procesi ka pasur defekte serioze<sup>6</sup>, gjë që më vonë është vërtetuar edhe nga shkresat e siguruar nga MAPL-ja dhe MMPH-ja që tregonin se kjo rregullore nuk ka bazë ligjore dhe se pjesa dërmuese e përmbajtjes së saj është kopjuar nga komunat tjera<sup>7</sup>.

Monitoruesit e "EC Ma Ndryshe" gjatë angazhimit të tyre njëvjeçar megjithëse kanë qenë të përqendruar në çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale kanë adresuar edhe tema të interesit nacional, siç është rasti i projektit Brezovica, që rrezikon vlerat e rralla natyrore. Hulumtimi disa mujor i "EC Ma Ndryshes" ka përfshirë mbledhjen dhe shqyrtimin e planit, të ligjeve si dhe kontaktet me ekspertët e kësaj fushe. Në bazë të analizave të deritanishme, projekti "Brezovica"

<sup>5</sup> "Prokuroria autorizon hetimet për ndërtimet pa leje në Prevallë", 30.11.2012, <http://www.koha.net/?page=1,31,125328>

<sup>6</sup> Reagim i Përbashkët EC Ma Ndryshe – KDI, [http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC\\_KDI\\_Reagim.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_KDI_Reagim.pdf)

<sup>7</sup> Komunikatë, [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_23\\_nentor\\_2012.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_23_nentor_2012.pdf)

edhe pse në opinion paraqitet si projekt zhvillimor me interes nacional lehtësisht mund të degjeneroj në shkatërrimin e shekullit të vlerave natyrore.

### III. Monitorimi në Komunën e Mamushës

Të arriturat e projektit "Online Transparency" në Prizren kanë qenë një faktor motivues për të zgjeruar monitorimin edhe në një komunë shtesë, respektivisht atë të Mamushës gjatë periudhës maj 2013 - mars 2014.

Mamusha është një komunë e re e decentralizuar vite më parë, me popullsi shumicë turke. Në këtë komunë ka pak organizata të shoqërisë civile dhe shumë pak raportim në media, përderisa strukturat qeverisëse në aspektin e praktikës demokratike janë mjaft të brishtë. Përfshirja EC Ma Ndryshe në Mamushë synon kryesisht të mbështes qeverinë lokale që aplikoj standardet e qeverisjes së mirë.

EC Ma Ndryshe në muajin maj të 2013-ës ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Komunën e Mamushës mbi monitorimin e ekzekutivit lokal, me të cilin dokument janë përkufizuar të drejtat e të dyja palëve.

Në rastin e komunës së Mamushës përgjigja ndaj monitorimit dhe të gjeturave të monitoruesve kanë qenë më pozitive krahasuar me atë të Prizrenit. Udhëheqja e kësaj komune asnjëherë nuk ka kontestuar të gjeturat e monitoruesve dhe në disa raste ka dhënë premtime se do të angazhohet për përmirësimin e defekteve të identifikuara. Madje ka mirëpritur edhe propozimet për fuqizimin e kapaciteteve në sferën e transparencës në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Megjithëkëtë komuna e Mamushës ende përballlet me sfida të shumta sa i përket transparencës dhe qeverisjes demokratike, që kryesisht vjen si pasojë e mungesës së përvojës dhe ambientit rrethues.

### IV. Konstatime të përgjithshme mbi transparencën

Transparenca luan rol të veçantë në përmirësimin e qeverisjes dhe luftimin e korrupsionit, kryesisht nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve, forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile në arenën publike dhe nxitjen e llogaridhënies më të hapur nga zyrtarët publik. Transparenca shërben si mjet për të krijuar dhe siguruar qytetari të informuar me qëllim që kufijtë e përgjegjësisë dhe veprimet e zyrtarëve të jenë të dukshme dhe në këtë mënyrë llogaridhënese. Transparenca, pra mbetet një nga shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë, meqë sistemet e mbyllura që përshkruhen me sjellje diskrete ofrojnë hapësirë për dyshime në lidhje me veprimet korruptive.

Gjatë periudhës njëvjeçare EC Ma Ndryshe është përballur me sfida të ndryshme gjatë hulumtimit të çështjeve të ndryshme. Dukuria e ofrimit të informatave gjysmake, duke mos iu përgjigjur në tërësi kërkesës për qasje në dokumentet publike ka qenë e pranishme.

Që prej fillimit të monitorimit, EC Ma Ndryshe shpesh herë ka theksuar se transparenca e komunës ka të meta strukturore dhe se përkundër përpjekjeve modeste të lidhshmeve komunal ajo vazhdon të jetë në nivel të ultë, që manifestohet me informim jo-adekuat, mos përfshirje të duhur në vendimmarrje dhe mungesë të llogaridhënies kundruall qytetarëve.

EC Ma Ndryshe ka raportuar mbi rrjedhën e ngadaltë të informatave dhe dokumenteve nga të gjitha drejtoritë te Zyra për Informim dhe Komunikim, gjë që ka sjell deri te mos publikimi i vendimeve në kohë reale dhe mos informimi i duhur i publikut për vendimmarrjen lokale.

Kjo dukuri ka vazhduar edhe në gjysmën e dytë të periudhës monitoruese, me ç'rast monitoruesit kanë identifikuar raste kur autoritetet komunale nuk i janë përgjigjur kërkesave të qytetarëve apo edhe të organizatave të shoqërisë civile, edhe pse dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike janë të qarta në këtë drejtim.

Gjithashtu procesverbalet nga diskutimet publike mbi buxhetin dhe çështjet tjera nuk janë hartuar dhe publikuar e as që janë hartuar listat e projekteve parësore të propozuara nga qytetarët gjatë debateve publike.

Prandaj EC Ma Ndryshe ka ardhur në përfundimin se transparenca në komunën e Prizrenit përkundër disa lëvizjeve pozitive ende mbetet në stadin fillestar, me potencialin për t'u përmirësuar, që kryesisht varet nga vullneti politik i drejtuesve të komunës. Kryetari i komunës dhe ekzekutivi lokal duhet të marrin masa adekuate që të njoftojnë me kohë publikun mbi vendimet, planet, projektet, buxhetin, hulumtimet dhe çështjet tjera me rëndësi.

## V. Të gjeturat specifike të monitorimit

### a) Komuna e Prizrenit

Gjatë 12 muajve të kaluar monitoruesit e transparencës së qeverisë komunale janë përqendruar në hulumtimin e çështjeve të ndryshme, që lidhen me mbrojtjen e interesit të qytetarëve të komunës së Prizrenit, si në urbanizëm, inspektorat, në arsim, shëndetësi,

prokurim, shërbime publike, transparencë, financa dhe buxhet, investimet jo të qëlluara, etj, të cilat janë paraqitur më poshtë:

*Komuna e paguan dy herë faturën e servisimit të automjetit të kryetarit*– Gjatë hulumtimit disa javor, EC Ma Ndryshe ka konfirmuar parregullsitë në pagesat për mirëmbajtje dhe riparim të automjetit të kryetarit të komunës, pasi që më parë edhe Raporti i Auditimit për vitin 2012 kishte konstatuar shkelje të procedurave të prokurimit dhe pagesën e dyfishtë të kësaj fature<sup>8</sup>.

*Qeveria komunale e Prizrenit vit pas viti abuzon me buxhetin lokal* – Gjatë vështrimit të raporteve të Auditimit të 5 viteve të fundit është vërejtur se gabimet e Komunës rreth menaxhimit të parasë dhe asetëve publike po përsëriten që një kohë të gjatë dhe se rekomandimet e ZAP-it nuk janë trajtuar në nivelin e kërkuar nga Komuna, në pesë vitet e fundit. Rekomandimet e ZAP-it në të shumtën e rasteve kanë identifikuar dobësi të shumta në lidhje me realizimin e buxhetit, arkëtimin e të hyrave vetanake, sistemin e prokurimit publik, menaxhimin e detyrimeve dhe menaxhimin e pasurive<sup>9</sup>.

*Vendosja e Lojërave në Qendrën Sportive* - Gratë dhe të moshuarit që jetojnë në lagjet afër Qendrës Sportive janë ankuar se vendosja e lojërave ka prishur qetësinë e tyre, pasi që ndotja akustike vazhdon deri në orët e vona të natës dhe se qytetarët privohen nga përdorimi i hapësirës së gjelbër në këtë qendër. EC Ma Ndryshe konsideron se nevojitet një nivel më i

<sup>8</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_gush\\_t\\_2.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_gush_t_2.pdf)

<sup>9</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_gush\\_t\\_19082013..pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_gush_t_19082013..pdf)



lartë i përgjegjësisë si nga menaxhmenti i QS-së ashtu edhe nga komuna në çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet që ndikojnë në jetën e përditshme të banorëve përreth<sup>10</sup>.

*Praktika e grumbullimit të hollave nga nxënësit në shkollat publike* – Monitoruesit kanë pranuar ankesa individuale nga prindërit e nxënësve në lidhje me mjetet që kërkohen nga menaxhmentet e shkollave publike të Prizrenit për pagesën e sigurimit fizik, mirëmbajtjes, rregullimit të sanitarive apo pagesa tjera shtesë. Duke paraqitur shqetësimin për përhapjen e kësaj dukurie, prindërit janë ankuar edhe për mungesë të transparencës në menaxhimin dhe shpenzimin e këtyre mjeteve shtesë<sup>11</sup>.

*Projekti “Brezovica” rrezikon shkatërrimin e vlerave të rralla natyrore* – Hulumtimi disa mujor i “EC Ma Ndryshes” ka përfshirë mbledhjen dhe shqyrtimin e planit, të ligjeve si dhe kontaktet me ekspertët e kësaj fushe. Ne bazë të analizave të deritanishme, projekti “Brezovica” edhe pse në opinion paraqitet si projekt zhvillimor me interes nacional lehtësisht mund të degjeneroj në shkatërrimin e shekullit të vlerave natyrore. Projekti “Brezovica” parasheh realizimin e investimeve në rreth tre mijë e pesëqind hektarët e territorit me vlera të rëndësishme natyrore të PK “Sharri”, që me vendim të Kuvendit të Kosovës është shpall interes nacional<sup>12</sup>.

*Investimet pa planifikim në shtëpinë e Shuaip Pashës* – Qeveria komunale respektivisht

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor ka nisur realizimin e projektit pa i sqaruar në tërësi kontestet pronësore me pronarët legjitim të këtij objekti, ndërkohë që nuk ka pas plan të qartë as për destinimin përfundimtar të kësaj shtëpie, që dikur ka përfaqësuar vlera të rralla të arkitekturës urbane të Prizrenit<sup>13</sup>.

*Komuna e pafuqishme në ndalimin e tejkalimeve në ndërtimet e larta* – Hulumtimi ka nxjerrë në pah faktin se qeveria komunale respektivisht Drejtoria e Inspektorateve është e pafuqishme në ndalimin e tejkalimeve në ndërtesat e reja të banimit kolektiv. Rrjedhimisht tejkalimet drastike të lejeve urbanistike në ndërtimet e larta janë bërë dukuri kronike në qytetin e Prizrenit. Konkretisht bëhet fjalë për objektin afarist-banesor në vendin e quajtur “Atmejdan” në rrugën “Tirana”, p.n., ku investitori përkundër shumë vërejtjeve të Drejtorisë së Inspektorateve ka vazhduar ndërtimin shtesë, ani pse para organeve komunale është zotuar se do t’i ndërpresë ato<sup>14</sup>.

*Inspektorati nuk posedon një listë të objekteve për rrënim* – EC Ma Ndryshe ka kërkuar nga Drejtoria e Inspektorateve të bëjë publike listën e objekteve apo ndërtimeve pa leje që duhen ekzekutuar (rrënuar) brenda territorit të komunës së Prizrenit. Në vend të listës, Drejtoria ka ofruar një përgjigje se është në

<sup>10</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_korrik\\_2.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_korrik_2.pdf)

<sup>11</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_korrik.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_korrik.pdf)

<sup>12</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/BREZOVICA\\_PDF.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/BREZOVICA_PDF.pdf)

<sup>13</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_gershor\\_1.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_gershor_1.pdf)

<sup>14</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_maj\\_2...pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_maj_2...pdf)



pritje të aprovimit të Ligjit për Legalizimin e objekteve<sup>15</sup>.

*Të gjeturat tjera specifike të monitorimit në Prizren mund të gjenden në dy raportet e mëparshme periodike "Degradimi natyror dhe urbanistik"<sup>16</sup> dhe "Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale"<sup>17</sup>.*

#### **b) Komuna e Mamushës**

*Komuna e Mamushës me dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar* – Raport i Auditimit ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar, që duhet të adresohen nga Komuna e Mamushës. Përfundimi i ZAP-it është se sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës nuk është përcaktuar dhe nuk është zbatuar siç duhet për të eliminuar dobësitë e dukshme. Sa i përket të hyrave vetanake të Komunës së Mamushës ZAP ka gjetur mangësi në sistemin e faturimit, mbledhjen e të hyrave vetanake dhe dobësi në sistemin e automatizuar të faturimit. Ndërsa te shpenzimet sfiduese mbetet çështja e prokurimit<sup>18</sup>.

*Shpenzimet e komunës për dreka jashtë kontrollit* - Komuna e Mamushës në gjashtë muajt e parë të këtij viti ka shpenzuar për dreka zyrtare më shumë se dyfishin e mjeteve që kishte shpenzuar gjatë tërë vitit 2012, pra 2

mijë e 670 euro në gjysmën e 2013-ës, përballë 1 mijë e 270 eurove të 2012-ës<sup>19</sup>.

*Mangësi të shumta në transparencën online* – Ueb faqja e komunës si dhe komunikimi me publikun nuk është në nivelin e duhur dhe karakterizohet me mungesë të përcjelljes së informatave bazike për qytetarët. Përditësimi i të dhënave në ueb faqe nuk bëhet në asnjërin prej gjuhëve zyrtare të komunës së Mamushës. Vendimet e qeverisë komunale nuk publikohen online përderisa ka sfida të shumta edhe në zbatimin e praktikave për qasjen në dokumentet zyrtare, ku nuk përfillen në mënyrë strikte standardet e përkufizuara me ligjin përkatës. Kryetari i komunës, Arif Bütüç është zotuar se do të bëjë përpjekje për të përmirësuar transparencën online sikurse edhe praktikën e qasjes në dokumentet zyrtare<sup>20</sup>.

*Emërtimi i shkollës në Mamushë, peng i (mos)komunikimit institucional* – EC Ma Ndryshe gjatë muajit maj ka shqyrtuar çështjen e ri-emërtimit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në këtë komunë. Në bazë të vrojtimeve gjatë monitorimit shihet se komuna e Mamushës përdor emrin "Anadolu" për këtë shkollë, derisa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në dokumentet zyrtare i referohet si ShFMU "Haxhi Ymer Lutfiu". Zgjidhja e kësaj çështjeje procedurale nuk do të duhej të zgjaste më shumë se dy vite, por do të duhej të zgjidhej në një afat optimal kohor, në mënyrë që emri zyrtar i shkollës të mos mbetet pezull<sup>21</sup>.

<sup>15</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/komunikate\\_inspektorati.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/komunikate_inspektorati.pdf)

<sup>16</sup> Raporti, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC\\_Degradimi\\_na\\_tyror\\_dhe\\_urbanistik\\_final\\_analiza.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_Degradimi_na_tyror_dhe_urbanistik_final_analiza.pdf)

<sup>17</sup> Raporti, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC\\_Respektimi\\_i\\_ligjit\\_ne\\_qeverisjen\\_lokale.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_Respektimi_i_ligjit_ne_qeverisjen_lokale.pdf)

<sup>18</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_Mamushe-Shtator.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_Mamushe-Shtator.pdf)

<sup>19</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/korrik\\_1\\_MA.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/korrik_1_MA.pdf)

<sup>20</sup> Komunikatë, linku: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_5\\_korrik.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_5_korrik.pdf)

<sup>21</sup> Komunikatë, linku: <http://www.online-transparency.org/repository/docs/mamusha.pdf>

## VI. Rekomandime

### **Rekomandime të përgjithshme (transparenca)**

Për të adresuar të metat e përgjithshme sa i përket transparencës së qeverive komunale në Prizren e Mamushë rekomandojmë që:

- Qeveria Komunale të zbatoj në përpikëri dispozitat e Udhëzimit Administrativ 2008/09 të MAPL-së për transparencë,
- Ekzekutivi lokal të raportoj më shpesh në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale dhe çështje tjera,
- Kryetari, drejtorët dhe shefi i Zyrës për Informim të mbajnë konferenca periodike të shtypit, por edhe të organizojnë seanca të pyetje-përgjigjeve me publikun e gjerë ose grupet e interesit,
- Të amendamentohet Rregullorja për Transparençë dhe të përfshihen në mënyrë eksplicite obligimet e kryetarit dhe ekzekutivit komunal në raport me transparencën lokale,
- Zyra për Informim të fuqizohet me personel dhe të bëj përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës me informacione relevante për qytetarët e komunës së Prizrenit,
- Të zbatohen në përpikëri dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike,
- Ueb faqet zyrtare të përditësohen me përmbajtje në të gjitha gjuhët zyrtare

### **Rekomandime specifike (sektoriale)**

Në bazë të të gjeturave të deritanishme në sektorët specifik të qeverisjes lokale, EC Ma Ndryshe rekomandon ndërmarrjen e një numri veprimesh për të përmirësuar praktikat e veprimit, vendimmarrjes dhe zbatimit të projekteve nga qeveria komunale në:

### c) Prizren

*Të zbatohet Ligji i Prokurimit Publik* – Kryetari i Komunës duhet të shqyrtoj arsyet pse kërkesat e prokurimit publik nuk janë aplikuar në disa raste dhe të sigurojë vendosjen e kontrolleve të duhura; Të respektohen dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në çdo shërbim, furnizim e tender; Të gjitha pagesat të bëhen në pajtim me kërkesat e kontratës dhe vetëm pasi të jenë bërë verifikimet e duhura se mallrat shërbimet e kontraktuara janë pranuar në sasinë dhe cilësinë e duhur.

*Të zbatohen të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm* – Ekzekutivi komunal duhet të tregoj përkushtim shumë më të lartë për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit në 5 vitet e fundit; Nevojiten përpjekje serioze të qeverisë komunale për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit brenda komunës së Prizrenit, në të gjitha fushat e identifikuara nga ZAP-i.

*Të ndalohet vendosja e Lojërave në Qendrën Sportive* - Menaxhmenti i Qendrës Sportive “Sezai Surroi” duhet të mbaj fjalën e dhënë në komunikimin me monitoruesit dhe të mos lejoj më vendosjen e lodrave, që shkaktojnë pakënaqësi te banorët e lagjeve përreth, për shkak të ndotjes akustike dhe ‘uzurpimit’ të hapësirave të gjelbra. DSHP-ja dhe autoritetet komunale duhet të dëgjojnë me vëmendje shqetësimet e qytetarëve dhe të ushtrojnë ndikimin e tyre publik, me qëllim të krijimit të një ambienti më të mirë jetësor për ta, në secilin rast. Edhe Bordi Mbikëqyrës për menaxhimin e objekteve kulturore dhe sportive në Prizren duhet të merr parasysh ankesat që shprehen nga qytetarët dhe të mos lejoj

vendosjen e lodrave në oborrin e QS-së në vitet e ardhshme.

*Të ndërpritet praktika e grumbullimit të hollave nga nxënësit* - DKA dhe kryetari i komunës duhet të vendosin dialog të afërt me MASHT-in, në mënyrë që lëshimet paraprake gjatë ndarjes së buxhetit për DKA-në e Prizrenit, të mos përsëriten më, por të ketë planifikim shumë preciz të pozicioneve buxhetore për rojet e natës, personelin ndihmës, pedagogët, psikologët, etj. në shkollat publike të komunës së Prizrenit. Shkollat, këshillat e prindërve dhe DKA-ja rekomandohen që praktikën e mbledhjes së fondeve për projekte të caktuara nga bashkësia dhe donatorët ta përcjellin me nivel të duhur të transparencës, duke i publikuar të dhënat për projektin, kohëzgjatjen, mjetet e grumbulluara dhe të shpenzuara dhe detajet tjera në tabelat e shpalljeve në shkolla, në ueb faqen zyrtare të komunës dhe në mjetet lokale të informimit.

*Të rishqyrtohet projekti "Brezovica"* - EC Ma Ndryshe rekomandon komisionin ndërministror, Kuvendin e Kosovës dhe të gjitha institucionet që të ndalojnë zhvillimin e Projektit në zonën A të PK-së, për shkak të vlerave të veçanta natyrore në këtë zonë. Po ashtu i bën thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që janë pjesë e komisioneve përkatëse, të ndërmarrin iniciativën për kërkimin e sqarimeve nga Qeveria e Kosovës dhe që debati për këtë çështje të jetë pjesë e diskursit publik, në mënyrë që të merren vendimet më të mira për fatin e PK "Sharri". Institucionet e Kosovës të ftojnë organizatat ndërkombëtare që merren me çështje ekologjike dhe mjedisore, si UICN, BE, WWF, REC, që t'i vlerësojnë pasojat e mundshme mjedisore të Projektit "Brezovica" para zhvillimit të mëtutjeshëm të projektit. Zhvillimi i turizmit të mos koncentrohet në një

zonë me sipërfaqe prej tre mijë e pesëqind hektarësh, por investimet të shpërndahen në mënyrë proporcionale në zonat tjera turistike, që janë të shumta në PK "Sharri".

*Paratë publike mos të investohen në projektet me konteste pronësore* - Komuna e Prizrenit rekomandohet që paratë publike mos t'i investoj në projektet që kanë konteste pronësore dhe pa një elaborim të thuktë për funksionalitetin dhe dobinë për qytetarët e Prizrenit, sic është rasti i Shtëpisë së Shuaip Pashë Spahiut.

*Të ndalohen tejkallimet në ndërtimet e larta* - Kryetari i komunës urgjentisht duhet të kërkoj nga DI-ja hartimin dhe publikimin e një liste të objekteve pa leje dhe me tejkallime që duhen rrënuar; Qeveria lokale sa më parë të nis procedurat për rrënimin e objekteve pa leje dhe me mbindërtime që nuk i janë përmbajtur planeve rregulluese urbane; Hetuesia dhe organet e drejtësisë duhet të trajtojnë në mënyrë serioze këtë çështje dhe të mundësojnë sundimin e ligjit në sferën e urbanizimit.

*Të hartohet lista e objekteve për rrënim* - Komuna e Prizrenit duhet të veproj konform përgjegjësive ligjore që ka dhe të marrë veprime konkrete për ndalimin e shkeljeve të kriterëve urbanistike. Në të kundërtën mungesa e gatishmërisë së qeverisë komunale për t'u ballafaquar me shkelësit e lejeve dhe planeve, krijon hapësirë për dyshime rreth përfshirjes së ekzekutivit të komunës në "krimin urbanistik" që e ka kapluar Prizrenin viteve të fundit

*Rekomandimet tjera të monitorimit në Prizren mund të gjenden në dy raportet e mëparshme periodike "Degradimi natyror dhe urbanistik" dhe "Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale".*

#### d) Mamushë

*Të zbatohen rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm* - Komuna e Mamushës duhet të tregoj përkushtim në zbatimin e 9 rekomandimeve të paraqitura nga ZAP-i në raportin e fundit dhe rekomandimet e viteve të kaluara; të krijoj një Komitet Auditimi dhe Departamentin e Auditimit të Brendshëm; të përmirësoj standardet e qeverisjes së parasë publike dhe lejoj kuvendarët e KK-së që të ushtrojnë kontroll dhe mbikëqyrje të shpenzimit të buxhetit komunal.

*Të kontrollohen shpenzimet në pjesën e dytë të vitit* – Lidershipi komunal duhet të jetë shumë më i kujdesshëm në pjesën e dytë të vitit me shpenzimet për dreka zyrtare. Natyrisht ky parim duhet të aplikohet edhe sa i përket shpenzimeve tjera, të kategorisë së dedikuar për mallra dhe shërbime në mënyrë që paraja publike të përdoret në përputhje me standardet e qeverisjes së mirë dhe specifikat që i ka Mamusha, si lokalitet.

*Të përmirësohet transparenca online* – Komuna e Mamushës duhet të zbatoj Udhëzimin Administrativ 2008/09 të MAPL-së për rritjen e transparencës si dhe të raportoj më shpesh në ueb faqe dhe në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale, etj.

*Të zgjidhjet çështja e emërimit të shkollës në Mamushë* – MASHT duhet të shqyrtoj çështjen e emërimit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët dhe t'i kthej një përgjigje meritore komunës së Mamushës. Ndërsa, komuna e Mamushës gjatë marrjes së vendimeve për emërtimin e shkollave duhet jetë e kujdesshme

në ndjekjen e procedurave të përcaktuara me ligje e akte nën-ligjore.

#### VII. Aktivitetet/raportimi

Në periudhën raportuese të projektit EC Ma Ndryshe ka ndërmarrë aktivitete të monitorimit duke përfshirë edhe avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore të komunës së Prizrenit. Monitorimi ka qenë i përqendruar në degët e ekzekutivit të komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi është kryer përmes monitoruesve permanentë, të cilët kanë pas prezencë të rregullt në mbledhjet e qeverisë lokale, zyrat komunale dhe qasje në dokumentet zyrtare të komunës.

Të gjeturat e monitorimit janë postuar në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org). Ueb-faqja është përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe përditësimi i përmbajtjes në të dyja gjuhët bëhet në kohë reale. Po ashtu janë lëshuar komunikatat e rregullta (dy-javore) për media, me informata përmbledhëse të të gjeturave të monitorimit.

Gjatë kësaj periudhe kryetari i komunës së Prizrenit ka mbajtur të hapura mbledhjet e qeverisë komunale për monitoruesit e EC Ma Ndryshe. Me qëllim të informimit të publikut me vendimet e marra EC Ma Ndryshe ka publikuar njoftime përkatëse rreth vendimeve të qeverisë lokale të Prizrenit.

Po ashtu ka realizuar kontakte me institucionet e nivelit qendror me qëllim të adresimit të kërkesave për respektim të ligjit dhe të Kushtetutës së vendit.

Në kuadër të projektit në muajin maj 2013 është organizuar tryeza e diskutimit “Degradimi natyror dhe ai urbanistik”. Panelistë të tryezës ishin z. Ian Cliff, Ambasador i Mbretërisë së

Bashkuar, z. Ruzhdi Rexha, nënkryetar i komunës së Prizrenit, z. Fisnik Minci, gazetar i Koha Ditore dhe z. Naim Cahanaj, koordinator nga KDI. Debati nxorri në pah zhvillimet në lidhje me degradimin natyror dhe atë urbanistik në komunën e Prizrenit.

Ndërkaq debati i titulluar “Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale” u organizua në dhjetor të vitit të kaluar. Panelistë të tryezës ishin Ian Cliff, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Ruzhdi Rexha, nënkryetar i komunës së Prizrenit, Refki Reshitaj, gazetar i Zërit dhe Elmedina Baxhaku nga EC Ma Ndryshe. Diskutimi i tryezës u zhvillua rreth temës së respektimit të ligjit në qeverisjen lokale të Prizrenit dhe bashkëpunimin mes aktorëve relevant lokalë për arritjen e standardeve të qeverisjes demokratike.

Tryeza tjetër e diskutimit “Bashkëpunimi media – shoqëri civile për qeverisje transparente” si panelistë ka pasur Ismet Kryeziun, Drejtor ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës, Arben Ahmetin, Kryetar i Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Pavarur të Kosovës dhe Ymer Berishën, Udhëheqës i Zyrës për Informim në komunën e Prizrenit. Pjesëmarrës në debatin e mbajtur në shkurt të 2013-ës kanë qenë edhe përfaqësues të medieeve, shoqërisë civile dhe të partive politike, të cilët janë pajtuar se nevojitet një angazhim më i madh dhe bashkëpunim më i afërt për rritjen e nivelit të transparencës. Në kuadër të tryezës ka lindur propozimi për themelimin e “Platformës Transparenca” në nivelin lokal, që do të funksiononte si mekanizëm i bashkëpunimit Shoqëri Civile-media për sigurimin e qeverisjes më transparente.

## VIII. Ndikimi i projektit

Gjatë 12 muajve të zbatimit të projektit Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe pesë muajve të zbatimit të projektit në Mamushë janë arritur rezultatet si në vijim: 27 komunikata për shtyp në çështjet që shtrihen nga urbanizmi e deri te shëndetësia dhe arsimi; 3 analiza mbi transparencën e qeverisë komunale dhe urbanizëm; 25 reagime publike, lajme dhe njoftime të shpejta mbi transparencën e qeverisë komunale; 20 njoftime nga takimet e kryetarit të komunës me drejtorët komunal; 4 debate mbi respektimin e ligjit nga qeveria lokale, bashkëpunimin media – shoqëri civile, urbanizmin dhe transparencën; sikurse edhe konferenca periodike për shtyp. Këto aktivitete janë mbuluar nga mediet (lokale dhe nacionale) sipas të dhënave në vijim: 145 kronika televizive me rreth 440 min paraqitje; gjithsejtë 112 artikuj gazetaresk me rreth 65 faqe, afër 250 raportime në ueb portale dhe rreth 235 minuta raportim në radio.

Projekti ka pasur ndikime të ndryshme mbi fushat që ka prekur. Dy nga më të rëndësishmet janë nisja e hetimeve nga Prokuroria Themelore për çështjet e urbanizmit dhe ngritja e aktakuzës për shpërdorimin e detyrës dhe autorizimeve ndaj zyrtarëve të lartë të qeverisë lokale të Prizrenit. Në të dyja rastet, projekti ka ofruar të dhëna të bazuara dhe i ka kontribuar zhvillimit të procedurave përkatëse nga ana e organeve të drejtësisë. Për më shumë, në sajë të projektit janë mundësuar edhe dy reagime nga Qeveria e Kosovës, me ç’rast Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal i ka dërguar një shkresë kryetarit të komunës dhe kryesuesit të KK-së në lidhje me rastin “Dardania” respektivisht nevojën e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, derisa Ministri i Kulturës

ka ofruar zotimin publik për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit pas publikimit të një numri raportesh mbi degradimin urban në këtë zonë.

Në maj të këtij viti kur Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pat marrë vendim që të ndërpriten të gjitha aktivitetet ndërtimore në zonën e Prevallës deri në afat të pacaktuar. Këtë vendim, ministri i MMPH-së, Dardan Gashi e ka marrë pas degradimit të mjedisit, gjegjësisht tejkallimit të kushteve dhe kriterëve për ndërtim dhe mosrespektimin e udhëzuesit të MMPH-së që ju ka dërguar Komunës së Prizrenit për mënyrën e zbatimit të planit urban për këtë zonë, gjë që është konstatuar disa herë më parë në komunikatat (dhjetor 2012-janar 2013) dhe analizën e “EC Ma Ndryshe” (prill 2013).

Projekti ka arritur që të hap mbledhjet e qeverisë lokale, duke i ofruar publikut informata të menjëhershme mbi vendimet e marra nga ekzekutivi komunal. Në fund, projekti është bërë një pikë legjitime dhe e besueshme e qytetarëve, të cilët kanë adresuar dhe vazhdojnë që t’i paraqesin shqetësimet e tyre në raport me qeverisjen komunale.

### IX. Për projektin

Ekzekutivi i komunës, i cili tashmë udhëhiqet nga kryetari i komunës (i cili i emëron dhe shkarkon drejtorët komunalë sipas vullnetit të tij personal), po promovon një cilësi të re të qeverisjes lokale dhe të ofrimit të shërbimeve publike. Ndonëse ky ndryshim nuk është gjithmonë pozitiv, ekzekutivi i komunës (sidomos kryetari) po shndërrohet në adresën e vetme të përgjegjesisë, dhe si pasojë të llogaridhënies, në raport me qeverisjen e mirë dhe shërbimet cilësore publike. Mbikëqyrja e punës së kryetarit (sidomos pjesa e ligjshmërisë) është ndër sfidat më të mëdha të

qeverisjes lokale në Kosovë. Derisa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal vlerësohet jo mjaftueshëm efektive, as Kuvendet Komunale dhe sistemi gjyqësor nuk dëshmojnë për cilësi më të larta. Dimensioni i fundit i kësaj mbikëqyrjeje, kontrolli qytetar, krahas pengesave politike, po has edhe në absurditete ligjore (Neni 72 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale për largimin e kryetarit nga detyra).

Janë evidentuar shumë raste gjatë këtyre dy mandateve të fundit, kur Kryetarë komunash kanë vepruar pa konsultim paraprak me Kuvendin Komunal dhe në shumë raste pa vendim të këtij organi. Kjo praktikë ka ngritur shqetësime të shumta në raport me respektimin e ligjit nëpër komunat e Kosovës.

Përkrahësit e sistemit mayoral janë të vetëdijshëm për formulën e dëmtimit të demokracisë në nivel lokal. Kjo formulë arrihet kur Kryetari i komunës tregohet shumë i sofistikuar në aftësitë e tij manipuluese, derisa në të njëjtën kohë Kuvendi Komunal tregohet i ngathtë në përmbushjen e obligimeve dhe ushtrimin e plotë të kompetencave (ligjore dhe mbikëqyrëse). Disa dyshime rreth keqpërdorimit të pushtetit ekzekutiv janë shfaqur në komunën e Prizrenit dhe zyrtarët e lartë komunal këtë vit po përballen me gjyqësorin, pasi që prokuroria e EULEX-it ka ngritur aktakuzë ndaj kryetarit dhe pesë bashkëpunëtorëve të tij nën dyshimin për shpërdorimin e detyrës zyrtare dhe të autorizimeve. Edhe Prokuroria e Qarkut të Prizrenit ka autorizuar Njësinë për Krime Ekonomike dhe anti-Korrupsion të Policisë së Kosovës për të hetuar disa raste të dyshimta në dikastere të ndryshme për korrupsion dhe shpërdorim të detyrës zyrtare nga zyrtarët e lartë komunal.



Për këtë arsye, monitorimi dhe raportimi për aktivitetet e keqeverisjes (sidomos të ekzekutivit të komunës) do të duhej të ishte detyrë primare e shoqërisë civile në raport me qeverisjen e mirë në nivel lokal.

Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës është projekt për monitorimin e punës së organeve komunale. Fokusi themelor i monitorimit është ekzekutivi i komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi bëhet përmes monitoruesve permanentë, të cilët kenë prezencë të rregullt në zyrat komunale dhe qasje të papenguar në dokumentet zyrtare të komunës. Raportimi i të gjeturave të monitorimit përdorë gjithashtu një mekanizëm permanent, ueb-faqen e transparencës së qeverisjes lokale. Të gjeturat e monitorimit postohen drejtpërdrejtë në ueb-faqen e projektit, për të krijuar mundësi qasjeje për të gjitha palët e interesuara. Të gjeturat e monitorimit janë bazë e veprimit për nivelin e dytë të aktiviteteve të projektit, avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore. EC Ma Ndryshe përdorë mundësitë ligjore për të nisur procedura të adresimit të shkeljeve ligjore nga ana e komunës.

Në gjashtë muajt e parë (mars-shtator 2012) pilot-projekti Transparenca online e komunës së Prizrenit është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ndërsa nga shtatori i vitit 2012 vazhdimi i projektit është mundësuar në sajë të mbështetjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, që në maj të këtij viti përkrahjen e ka zgjeruar edhe për monitorimin e komunës së Mamushës.

Qëllimi themelor i projektit është forcimi i qeverisjes së mirë në komunën e Prizrenit dhe të Mamushës. Objektivat specifike që do të

ndihmojnë arritjen e këtij qëllimi janë: Përmirësimi i nivelit të informimit të përgjithshëm të publikut mbi vendimmarrjen lokale, Aktivizimi i mekanizmave qeveritarë dhe gjyqësorë për adresimin e praktikave që cenojnë ligjshmërinë, Rritja e nivelit të transparencës komunale në vendimmarrje, Rritja e vigjilencës së vendimmarrësve lokalë në raport me respektimin e ligjshmërisë në qeverisjen lokale, Rritja e pjesëmarrjes së grupeve të komunitetit në vendimmarrjen lokale.

#### X. Pse monitorim i transparencës?

Në dekadën e kaluar fokusi ndaj transparencës, si një aspekt i përmirësimit të qeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit, ka qenë në nivel kombëtar, që lidhet kryesisht me prirjet globale të pluralizmit, demokratizimit dhe përmirësimit të qeverisjes. Në një aspekt, kjo është e kuptueshme, pasi që korrupsioni - pasojë më e spikatur e mungesës së transparencës – shpesh është më i dukshëm në nivel kombëtar, dhe për shkak se institucionet e legjislativit, ekzekutivit apo gjyqësorit kanë qenë pikë tradicionale e referencës për luftimin e korrupsionit. Kohët e fundit, megjithatë, ekziston një ndryshim në drejtim të rritjes së transparencës në nivel lokal.

Gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë. Janë dy aspekte themelore të qeverisjes (dhe qeverisjes së mirë). Së pari, koncepti i qeverisjes është më i gjerë se qeveria. Në kontekstin urban, kjo do të thotë se përgjegjësia për menaxhimin e çështjeve të një qytetit nuk është e kufizuar në pushtetin lokal, por përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të palëve të interesuara, duke përfshirë: qeverinë qendrore



dhe lokale, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe ato të bazuara në komunitet, mediet, shoqatat profesionale dhe anëtarë të tjerë të shoqërisë civile. Së dyti, koncepti i qeverisjes fokusohet në institucionet dhe proceset. Në kontekstin e burimeve të pakta, që konkurrojnë, por të vlefshme, prioritetet duhet të vendosen me anë të proceseve që përfshijnë të gjitha palët e interesuara në vendimmarrje. Kjo ka implikime të rëndësishme për zhvillimin e një kornize për promovimin e transparencës në nivel lokal.

Transparenca në proceset vendimmarrëse dhe në institucione ka potencial të bëhet një strategji qendrore për t'u angazhuar aktorët, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes urbane në përgjithësi. Prandaj, transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lirë në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, të jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive. Çështjet se kush e prodhon atë informacion, dhe për çfarë qëllimi, bëhen aspekte kyçe të transparencës, kur interesat konkurrense konvergojnë në një çështje të veçantë. Një nga modelet më të avancuara për sigurimin e transparencës është korniza pesëpikëshe për rritjen e transparencës: 1.

Vlerësim dhe monitorim, 2. Qasje në informacion, 3. Etikë dhe integritet, 4. Reformë institucionale dhe 5. Trajtimi i çështjeve specifike.

## XI. Falënderim

EC Ma Ndryshe është thellësisht mirënjohëse ndaj Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, që ka vlerësuar këtë projekt dhe ka vendosur ta mbështesë financiarisht duke filluar nga muaji shtator 2012. Po ashtu ka mundur të vendosjen e dialogut me ekzekutivin e komunës, të cilët në fazën e dytë janë treguar më të hapur në ofrimin e qasjes në dokumentet zyrtare, për të cilën gjë po ashtu jemi mirënjohës. Një falënderim i veçantë i takon edhe Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, që ka ofruar mbështetje financiare për fazën e parë (testuese) të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit", e cila përkrahje ka qenë thelbësore në konsolidimin e këtij projekti.

## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale në Prizrenit për të krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

*Projektet kryesore:* Urbanism Watch, Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjiilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës (2012 - 2013), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

*Publikimet:* “Prizreni qytet kulturor”, film dokumentar (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (pritet të publikohet në shtator 2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Katër analiza të projektit “Online Transparency”: 1. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 2. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 3. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 4. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).